



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e I-rë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17 janar 2024
në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:20.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i Komunës), Shpëtim Zhegrova (Nënkryetar i Komunës), drejtorët e drejtorive, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo tha se na kanë ardhur disa pika shtesë për t'u futur në rend të ditës:

- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës.
KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndarje të mjeteve financiare - Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” Sh.a në Vushtrri.
KPF-ja me pesë (5) vota “për”, dy (2) “kundër”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndarje të dekoratës “Nderi i Qytetit” për Heronjtë e Kosovës: Enver Zymberi (post mortum) dhe Afrim Bunjaku (post mortum).
KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për financim të shkollimit të fëmijëve të Heronjve të Kosovës Enver Zymberi dhe Afrim Bunjaku.
KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit për KKSBNë.
KPF-ja me pesë (5) vota “për”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

Komiteti për Politikë dhe Financa me pesë (5) vota “për” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.12.2023;
2. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve për periudhën janar – dhjetor 2023;
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës;
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndarje të mjeteve financiare - Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” Sh.a në Vushtrri;
5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndarje të dekoratës “Nderi i Qytetit” për Heronjtë e Kosovës: Enver Zymberi (post mortum) dhe Afrim Bunjaku (post mortum);
6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për financim të shkollimit të fëmijëve të Heronjve të Kosovës Enver Zymberi dhe Afrim Bunjaku;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit për KKSBNë;
8. Pyetje dhe përgjigje.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.12.2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 13.12.2023.

2. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve për periudhën janar – dhjetor 2023.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se e dimë se si ka ndodhur realizimi i buxhetit, pra për shkak të ekzekutimit të pagesave që janë paraparë me Kontratën Kolektive për punëtorët e arsimit. Edhe pse të gjithë nuk i kanë gëzuar të drejtat e tyre në këtë vit, sepse ka pasur një selektim. Ai kërkoi nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa që për senacë të kuvendit të na bashkëngjitet realizimi i investimeve kapitale (nga të gjitha drejtoritë). Sa është realizuar secili kod buxhetor, projekt? Sa të tjera janë pagesë e procedurave gjyqësore apo marrëveshjes në mes Komunës – Gjykatës – Sindikatës së Arsimit.

Këtu po figurojnë që janë realizuar projektet, por në fakt nuk janë realizuar. Është mirë ta dimë se cilat projekte janë realizuar e cilat jo, në mënyrë që si kuvend t'i shtyjme këto projekte që të realizohen së paku këtë vit. Në momentin që votohet buxheti, ai shndërrohet në ligj dhe nuk mund të vazhdohet me buxhet të investimeve kapitale për vitin 2024, derisa nuk janë kryer obligimet në vitin 2023, njëjtë edhe për vitin 2022. Cili është fati i këtyre projekteve?

Prandaj, për kuvend të plotësohet kjo informatë dhe t'i bashkëngjitet realizimi i investimeve kapitale.

Disa mësimdhënës e kanë paraqitur si shqetësim listën e përfituesve, ku disa e kanë fituar të drejtën në vitin 2023 e disa i kanë lënë për vitin 2024. Disa kanë qenë përfitues të inflacioni dhe të licencimi, kurse disa nuk kanë përfitur ende. Prandaj, disa mësimdhënës janë diskriminuar. Kush i ka përpiluar këto lista?

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – theksoi se kemi qenë të detyruar ligjërisht për shkak të opinionit që e ka dhënë Gjykata Supreme për mësimdhënësit. Ai tha se jemi komuna e vetme që kemi arritur ta bëjmë një gjë të tillë, duke marrë një rrezik të ndërmjetësimit të pagesave të licencave dhe inflacionit për mësimdhënësit.

Rendi ka qenë që Ministria e Arsimit është dashur t'i bëjë këto pagesa si nënshkruese e Kontratës Kolektive me sindikatat, e jo komunat. Ne jemi duke u shtyrë në gjykatë me ministrinë dhe besoj fuqishëm që do ta fitojmë rastin. Megjithatë, në këtë turbullirë, ne i kemi bërë këto pagesa, por edhe i kemi kursyer mbi 1 milion euro kamata të avokatëve. Kjo ka qenë marrëveshja e ndërmjetësimit në mes të Komunës, Gjykatës dhe Avokatëve, e jo me sindikatën.

Arsyeja se pse nuk janë paguar një pjesë e mësimdhënësve, është se nuk ka pasur mundësi Ministria e Financave ta bëjë ekzekutimin, për shkak se ka qenë fundi i vitit. Por, të gjitha ato mjete do t'i marrin mësimdhënësit dhe presim nga Ministria e Financave që ta fillojë ekzekutimin e pjesës tjetër të mjeteve.

Listat janë përgatitur nga avokatët, jo komuna.

Ai tha se projektet që kanë qenë të planifikuara do të realizohen.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – deklaroi se e falënderon kryetarin e komunës për përgjigjen e shpejtë, por është mirë mësimdhënësve me ua sqaruar që këtë punë e kanë bërë avokatët. Por, në anën tjetër avokatët nuk po e pranojnë që i kanë bërë listat. Ata po thojnë që Thesari i ka bërë listat.

Po të them kryetar që sa i përket marrëveshjes mirë ke vepru, sepse ma mirë është që mos me shkuar mjetet suficit, për shkak se prapë këto mjete kanë mbetur në Vushtri.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – Sylejman, edhe unë të falënderoj për këtë qasje, sepse shpejtisht ashtu është. Është dashur t'i informojë mësimdhënësit. Arsyeja se pse nuk e kemi nisur këtë punë më herët është sepse është dashur të sigurohemi në Ministri të Financave se a na i ekzekutojnë pagesat. Por, do të interesohem personalisht se deri ku ka shkuar procedura e këtyre pagesave.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që me plotësim (të bashkëngjitet realizimi i investimeve kapitale) të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – deklaroi se kjo do të ishte një ndihmesë sado pak për zyrtarët e administratës së komunës, sepse një pjesë e tyre kanë paga shumë të ulëta. Jemi informuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa që pagesa mund të bëhet nga kategoria “subvencione dhe transfere”, kurse shuma financiare vjetore është rreth 240 mijë euro, në vlerë ditore prej 3 euro. Prandaj, këto janë mundësitë buxhetore. Po ashtu, e kam një sugjerim për anëtarët e kuvendit që mos të japin propozime, kur nuk ka arsyeshmëri financiare, pra kur nuk ka mjete buxhetore. Nëse merret një vendim në kuvend dhe nuk ka mjete buxhetore, kryetari i komunës nuk ka obligim ligjor me zbatuar një vendim të tillë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se kemi vullnet për ta mbështetur një vendim të tillë, por nëse ka mundësi të na sqaroni edhe një herë bazën ligjore për pagesën e shujtave. Kjo për shkak se Ligji i Pagave e ka rregulluar këtë çështje dhe se prej kategorisë <paga dhe mëditje> nuk mund të paguhen. Po ashtu, është keqklasifikim nëse paguhen nga subvencionet, sepse shujtat llogariten si shtesë e pagës. Prandaj, nëse keni mundësi të na jepni një sqarim ligjor, sepse kam frikën që ne do ta miratojmë, por se di a do ta kalojë ligjshmërinë nga niveli qendror.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – deklaroi se kryetari në mbledhjen e kaluar i përmendi se edhe zjarrfikësit do të jenë pjesë e këtij vendimi. Por, në vitin 2023 është miratuar një vendim për shujtat e zjarrfikësve. A po zbatohet ky vendim?

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – lidhur me pyetjen për shujtat e zjarrfikësve do të interesohem se deri ku ka shkuar çështja dhe do t'ju njoftojmë.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – theksoi se zyrtarët e administratës komunale e meritojnë shujtën ditore, qysh e kemi diskutuar edhe disa herë këtë çështje. E përshëndes këtë propozim-vendim që ka ardhë nga kryetari i komunës. Mirëpo, nëse MAPL-ja e kthen si të paligjshëm këtë vendim, a keni gjetur ndonjë alternativë tjetër për pagesën e shujtave për zyrtarët.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – tha se nuk ka qenë qëllimi që vetëm ta procedojmë në kuvend, por jam konsultuar me zyrtarët e komunës rreth ligjshmërisë dhe kam marrë informacione se nga fondi për subvencione kemi të drejtë ta bëjmë pagesën. Por, nëse kontestohet ligjshmëria nga MAPL-ja, atëherë nuk kemi çka. Nëse dikush ka ndonjë alternativë tjetër ligjore le ta paraqet lirisht, sepse jemi që ta shtyjmë përpara këtë çështje. Nëse ky vendim kthehet i ligjshëm nga MAPL-ja, do ta fillojmë ekzekutimin. Nëse ka ndonjë pengesë nga Ministria e Financave, do ta analizojmë se për çka është fjala dhe bashkërisht do ta shtyjmë përpara.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – ju kisha sugjeruar që të kontaktoni me Komunën e Prishtinës, sepse ata i kanë realizuar shujtat, por nuk e di në çfarë forme.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës – deklaroi se vitin e kaluar e kemi diskutuar për rastin e Komunës së Prishtinës. Ata e kanë bërë në një formë tjetër, ku kanë shpallur tender dhe e kanë kontraktuar një market, ku zyrtarët janë furnizuar me produkte ushqimore dhe gjëra tjera. Unë e kam dhënë si propozim, por ndoshta më vështirë i realizueshëm, nga kategoria <mallra dhe shërbime> të kontraktohen 2 apo 3 restorante me zona dhe zyrtarët të shkojnë për ushqim. Por, kjo formë ndoshta nuk ju pëlqen zyrtarëve të administratës.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndarje të mjeteve financiare - Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” Sh.a në Vushtri.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – siç e dini, NPL “Përparimi” e ka zgjeruar aktivitetin e shërbimeve edhe me mbledhjen e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë. Kjo është e mirë, sepse është ndërmarrje komunale, kurse në bazë të përlllogaritjeve tona, komunës do t’i mbesin rreth 20 mijë euro. Ndërmarrja ka nevojë edhe për një mbështetje, sepse aktualisht po punojnë me dy ndërrime dhe me pesë kamiona. Ka qenë edhe një herë në KPF dhe ndoshta nuk kemi bërë sqarimet e duhura. Kjo ndërmarrje do të ketë edhe shërbime të tjera, ku këtë vit kemi planifikuar që t’ua japim edhe mirëmbajtjen e varrezave edhe nëpër fshatra. Po ashtu, do ta marrin nën menaxhim edhe pastrimin (larjen) e rrugëve.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se në muajin e kaluar e kemi kundërshtuar, jo se pse nuk ia duam të mirën ndërmarrjes, por deri më tani funksionimi i saj ka qenë i brishtë dhe ka lënë vend shumë për dyshime. Ne disa herë në kuvend i kemi përkrahur dhe i kemi subvencionuar si ndërmarrje, por kemi marrë pak raporte prej tyre. Edhe atë raport që e kemi marrë, ka qenë me shumë skandale. Kemi parë që janë blerë mjete motorike të amortizuara, ku disa prej tyre nuk regjistrohen fare. Është dashur të rritet kontrolli i mbikëqyrjes se a janë funksionale, se çmimi i tyre i tregut a përputhet me mjetet motorike etj. Subvencionet e komunës po përdoren për blerjen e makinerisë, pra po përdoren për investime kapitale. Pra, a lejohet kjo çështje?

Çështje tjetër është se shumë pak ka pasur subvencione në bujqësi. Vushtrria është vend bujqësor dhe është dashur të ndahen më shumë subvencione.

Prandaj, mirë është që të mbijetojë kjo ndërmarrje dhe të arrijë që të gjenerojë mjete financiare dhe të funksionojë vetë, por deri më tani vetëm e ka ngarkuar buxhetin e komunës dhe ka lënë shumë hapësirë për dyshime, sa i takon menaxhimit të saj.

Nuk kam asgjë kundër ndërmarrjes, e aq më pak ndaj punëtorëve që janë më së paku fajtor, por jam kundër menaxhmentit të ndërmarrjes dhe nuk do ta votojë këtë propozim-vendim.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – u përmend bujqësia, ne kemi hyrë në bashkëfinancim me “Islamic Relief”, ku do t’i subvencionojmë 270 serra nga kategoria<subvencione dhe transfere>. Atje bëhet kategorizimi, pra se çfarë impakti ka për komunën.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – e kam thënë edhe në muajin e kaluar se nuk jemi kundër ndërmarrjes, por jemi kundër disa gjërave që nuk kanë funksionuar aty siç duhet. Prandaj, kemi kërkuar edhe atëherë, po kërkojmë edhe tash që të mbikëqyrret nga organet e komunës (siç është komisioni i aksionarëve), në mënyrë që të mos keqpërdoret paraja publike.

E dimë që ndërmarrja ka filluar me mbledhjen e mbeturinave këtë vit dhe po has në vështirësi financiare, jemi që ta përkrahim këtë propozim-vendim, por parkingu i automjeteve tek zyret e ndërmarrjes është jo i mjaftueshëm dhe në atë vend po krijohet tollovi për shkak të shkollës që është afër. Ai propozoi që të caktohet një lokacion për parking dhe me vendim të kuvendit t’iu ipet në shfryshëtim NPL “Përparimit”.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – pajtohem që ai parking është jo i mjaftueshëm dhe ka tollovi aty. Objekti ku i kanë zyret do të rregullohet, por edhe hapësira që po shfrytëzohet

aty për parking do të rregullohet se ka shumë baltë. Ai tha se do ta sjellin në kuvend propozim-vendimin për caktim të lokacionit për parking.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – deklaroi se përballë Kalasë së Qytetit, janë disa banesa të komunës, prapa tyre janë disa bodrume. Në kohën sa kam qenë drejtor, disa uzurpator kanë tentuar t'i uzurpojnë ato lokale. Edhe kryetarit të atëhershëm i kam propozuar që ato lokale mund të bëhen zyre. Prandaj, është vend i mirë për t'u shfrytëzuar si zyre për NPL "Përparimi" ose për diçka tjetër.

Shpëtim Zhegrova, Nënkryetar i komunës – theksoi se parkingu aktual i ndërmarrjes është jo i mjaftshueshëm dhe nuk kishte hapësirë për pajisje, kamionët me vështirësi qarkullonin në atë vend. Prandaj, ajo hapësirë nuk i plotësonte kushtet për parking adekuat. Ai tha se tek njësia e zjarrfikësve është një hapësirë 40 ose 50 ari dhe është një propozim i mirë që aty të jetë parking për ndërmarrjen, sepse edhe qasja është më e lehtë.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – pajtohem plotësisht për çështjen e parkingut, sepse ato mjete që gjenden në oborrin e ndërmarrjes duhet të largohen prej aty dhe të vendosen diku në periferi, sepse edhe kundërmojnë, lirojnë baltë.

Po ashtu, në vendin ku kanë qenë zyret e "Unitetit", do ishte mirë të ndërtohet një çerdhe, sepse shkolla "Naim Frashëri" është afër

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota "për", dy (2) "kundër", rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndarje të dekoratës "Nderi i Qytetit" për Heronjtë e Kosovës: Enver Zymberi (post mortum) dhe Afrim Bunjaku (post mortum).

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – e përshëndesim këtë propozim-vendim dhe e meritojnë të respektohen Heronjtë e Kosovës: Enver Zymberi dhe Afrim Bunjaku. Fati ka dashur që të jenë nga komuna jonë këta dëshmorë. A do t'iu ndahet çmimi për "Ditën e Çlirimit", apo jashtë procedurës së rregullt?

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – e kemi sjellë këtë propozim-vendim që bashkërisht t'i nderojmë Heronjtë e Kosovës: Enver Zymberi dhe Afrim Bunjaku. Ideja ka qenë që ky çmim t'iu ndahet "Ditën e Pavarësisë" më 17 shkurt dhe ta bëjmë një organizim të mirë.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për financim të shkollimit të fëmijëve të Heronjve të Kosovës, Enver Zymberi dhe Afrim Bunjaku.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – theksoi se ekziston Rregullorja për Bursa, e cila ka disa zbrazëtira juridike dhe na duhet ta sjellim në kuvend për ta plotësuar, sepse nuk e parasheh këtë ndarjen e mjeteve për këtë kategori në mënyrë decitive. Prandaj, Heronjtë e Kosovës,

Enver Zymberi dhe Afrim Bunjaku kanë fëmijë në shkollë dhe qëllimi është që ta merr komuna në përgjegjësi mbulimin e shpenzimeve të shkollimit. Kurse, vlerën financiare e përcakton Drejtoria për Arsim.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – ndoshta më e rrugës do të ishte me ju jep bursa deri në përfundim të shkollimit.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – tha se më mirë do të ishte që të bëhet plotësim-ndryshimi i Rregullores për Bursa dhe përmes saj të rregullohet kjo çështje, në mënyrë që mos të kthehet nga MAPL-ja.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës – deklaroi se ky propozim-vendim nuk është në kundërshtim me rregulloren. Ky është një autorizim që u ipet Krytarit të komunës dhe Drejtorisë për Arsim që në formë të bursës t'iu ndahet fëmijëve të tyre deri në përfundim të shkollimit. Nga MAPL-ja sigurt do të kthehet pozitiv, tha ai.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit për KKSBNë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

8. Pyetje dhe përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi



Kryesuese e KK-së dhe KPF- së